

V E N D I M

I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "ANMETAL" sh.p.k

Në Durrës, sot me datë 29.06.2023, në ambjentet e Selisë së Shoqërisë, nën thirrjen e Administratorit, mbahet mbledhja e shoqërisë

Janë prezent Ortakët:

1. Aleksandro Bardhi, zotërues i kuotës 100.00% të kapitalit

Mbledhjen e kryeson Administratori Z. Aleksandro Bardhi
Administratori e deklaroi mbledhjen të hapur me këtë;

Rend Dite: 1. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë dhe emërimi i audituesit ligjor për kryerjen e kësaj procedure.

Fillon shqyrtimi i problemeve të Rendit të ditës...

Flet Ortaku i Vetëm Aleksandro Bardhi, i cili thotë:

Lidhur me çështjen Rend Dite;

Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, unë jam dakort për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë dhe emërimin e audituesit.

Si përfundim, Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë,

V E N D O S I :

- ✦ Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 100.000.000 Lek. Këto fonde do të merren nga fitimi i vitit ushtrimor 2022.
- ✦ Emërimin e z. Elton Tirana me numër liçense 257, si auditues për kryerjen e procedurave të nevojshme për zmadhimin e kapitalit.

Më pas mbledhja e Shoqërisë deklarohet e mbyllur.

O R T A K U I V E T Ë M

(ALEKSANDRO BARDHI)



VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE "ANMETAL" SH.P.K.

Sot, më datë 04/07/2023 u zhvillua Mbledhja e Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Tregtare "ANMETAL" SH.P.K me numër nipti L31804503A, person juridik regjistruar në QKB me datë 04/06/2013.

Në mbledhje morën pjesë :

1. Z. Aleksandro Bardhi, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë me 100 pjesë kapitali me vlerë nominale 1,000,000 lekë secila, që përfaqësojnë 100% të Kapitalit Themeltar të nënshkruar.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Audituesit Ligjor për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë "ANMETAL" Sh.p.k me anë të transferimit të shumës prej 100,000,000 Lekë nga Ortaku në llogarinë e shoqërisë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimeve të statutit si rezultat i rritjes së kapitalit të shoqërisë.

Me Vendimin e datës 29/06/2023, ortaku ka rënë dakord që të zmadhojë kapitalin e shoqërisë me shumën prej 100,000,000 Lekë.

Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakut të vetëm të Shoqërisë ka rënë dakord për emërimin në cilësinë e audituesit ligjor për përgatitjen e raportit për rritjen e kapitalit të shoqërisë me shumën e 100,000,000 Lekë, transferuar nga Ortaku në llogarinë bankare të Shoqërisë, z. Elton Tirana, mbajtës i Liçensës së Audituesit Ligjor nr. 257.

Audituesi Ligjor i ka paraqitur Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë Raportin për Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet shumës së transferuar nga ortaku në llogarinë e Shoqërisë në shumën e 100,000,000 Lekë.

Mbledhjen e hapi z. Aleksandro Bardhi, i cili e quajti të vlefshme asamblenë meqenëse Ortaku i Vetëm me të drejtë vote që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të nënshkruar dhe duke qenë se qorumi i kerkuar nga ligji dhe Statuti është arritur, Asambleja është mbledhur në sesion të vlefshëm dhe procedon në marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës.

Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligiin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

.....

Në lidhje me pikat e Rendit të Ditës, Ortaku i Vetëm vendosi :

1. Të miratojë Raportin e Audituesit Ligjor, z. Elton Tirana, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ANMETAL" Sh.p.k në shumën e 200,000,000 Lekë.
 - Pra, kapitali i nënshkruar i shoqërisë nga 100,000,000 Lekë rritet dhe me 100,000,000 lekë duke rezultuar në 200,000,000 lekë pas zmadhimit.

- Vlera nominale për kuotë rritet nga 1.000.000 lek para rritjes së kapitalit në 2.000.000 lek pas zmadhimit.
 - Numri i kuotave mbetet i njejte si para zmadhimit dhe pas zmadhimit se kapitalit.
2. **Të miratojë** ndryshimet në Statutin e Shoqërisë në pjesën e Kapitalit Themeltar, i cili riformulohet si më poshtë:
- Kapitali Themeltar i shoqërisë nga **100.000.000 lekë** rritet me 100.000.000 lekë dhe arrin në 200.000.000 lekë.
 - Vlera nominale për kuotë mbas rritjes së kapitalit bëhet 2.000.000 lekë/kuotë.
 - Numri i kuotave mbetet i njejte dhe pas zmadhimit se kapitalit.
 - Zotërimi i kuotave është si vijon:
Ortaku 100 kuota (100% të kapitalit të Shoqërisë).
3. Asambleja e Ortakut autorizon z. Aleksandro Bardhi me nr. Personal J40831094L, për depozitimin e këtij Vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë QKB, së bashku me aktet e tjera dhe ndjekjen e të gjitha procedurave dhe veprimet e regjistrimit online.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje të Përgjithshme të Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë. Duke qenë se nuk pati çeshtje të tjera në rendin e ditës, mbledhja u mbyll.

Për Shoqërinë Tregtare

“ANMETAL” SH.P.K

**Ortaku i Vetëm
Aleksandro Bardhi**

